



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Udhëzues rreth nenit 4 të Protokollit nr. 4
të Konventës Evropiane
të të Drejtave të Njeriut

Ndalimi i dëbimit kolektiv
të të huajve

Përditësuar më 30 prill 2017

Botuesit ose organizatat që dëshirojnë ta përkthejnë dhe/ose ta riprodhojnë të plotë a pjesërisht këtë raport, në trajtë botimi të shtypur apo elektronik (në internet), janë të lutur t'i drejtohen publishing@echr.coe.int për t'u njohur me formalitetet e dhënies së lejes.

Ky udhëzues është përgatitur nga Drejtoria e Këshilltarit Juridik dhe nuk e kushtëzon Gjykatën. Atij mund t'i bëhen rishikime në redaktim.

I botuar për herë të parë në prill 2016, ky udhëzues përditësohet me rregullsi, në varësi të zhvillimit të jurisprudencës. Përditësimi i fundit është bërë më 30 prill 2017.

Udhëzuesi mund të shkarkohet nga interneti në adresën e mëposhtme: www.echr.coe.int (Case-law – Case-law analysis – Case-law guides). Për çdo informacion të ri lidhur me botimet, jeni të lutur të shihni llogarinë Twitter të Gjykatës: <https://twitter.com/echrpublication>.

Ky përkthim është publikuar në marrëveshje me Këshillin e Evropës dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përkthimi është financuar dhe është përgjegjësia e vetme e Programit të Përbashkët të BE/KiE “Rritja e Efektivitetit të Sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Anti-diskriminimit”.

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2017

Tryeza e lëndës

Njoftim për lexuesin	4
I. Zanafillat dhe objekti i nenit.....	5
II. Përkufizimi i termit “dëbim kolektiv”	5
III. Fusha individuale e zbatimit: përkufizimi i termit “të huaj”	6
IV. Zbatueshmëria territoriale dhe juridiksioni	6
V. Shembuj dëbimesh kolektive	7
VI. Shembuj masash që nuk përbëjnë dëbim kolektiv.....	9
VII. Marrëdhënia me nenin 13 të Konventës	10
Lista e çështjeve të cituara.....	11

Njoftim për lexuesin

Ky udhëzues bën pjesë në serinë e Udhëzuesve rreth Jurisprudencës të botuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më tej “Gjykata”, “Gjykata Evropiane” ose “Gjykata e Strasburgut”), me qëllimin për t’i informuar specialistët e së drejtës për vendimet themelore të dhëna prej saj. Në këtë rast, ky udhëzues analizon e përmbledh jurisprudencën lidhur me nenin 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më tej “Konventa” ose “Konventa Evropiane”) deri më 30 prill 2017. Lexuesi do të gjejë aty parimet kyç të përpunuara në këtë fushë si edhe precedentët përkatës.

Jurisprudenca e cituar është zgjedhur midis vendimeve pilote, të rëndësishme dhe/ose të kohëve të fundit*.

Vendimet e Gjykatës jo vetëm japin gjykim për çështjet që i paraqiten asaj, por shërbejnë gjithashtu edhe më gjerë për të qartësuar, ruajtur e zhvilluar normat e Konventës; ato japin kështu ndihmesë për respektimin, nga ana e shteteve, të zotimeve që këto kanë marrë në cilësinë e tyre si Palë Kontraktuese (*Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 154, seria A nr. 25). Sistemi i krijuar nga Konventa ka pra si qëllim që të japë gjykim, në interesin e përgjithshëm, për pikat që i përkasin rendit publik, duke i ngritur më lart normat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe duke e zgjeruar jurisprudencën në këtë fushë tek e tërë bashkësia e Shteteve Palë në Konventë (*Konstantin Markin k. Ruisë* [DhM], nr. 30078/06, § 89, GjEDNj 2012).

Ky udhëzues përmban referimin e fjalëve kyç për secilin nen të cituar të Konventës ose të Protokolleve të saj shpesh. Pikat juridike të trajtuara në secilën çështje janë sintetizuar në një [Listë fjalësh kyç](#), të zgjedhura nga një fjalës termash të nxjerrë drejtpërdrejt (më së shumti) nga teksti i Konventës dhe i Protokolleve të saj.

[Baza e të dhënave HUDOC](#) e jurisprudencës së Gjykatës jep mundësi për të bërë kërkime me anë fjalësh kyç. Kërkimi me këto fjalë kyç do t’ju lejojë kështu të gjeni një grup dokumentesh me një përmbajtje të ngjashme juridike (arsyetimi dhe konkluzionet e Gjykatës për secilën çështje janë përmbledhur me anë fjalësh kyç). Fjalët kyç për secilën çështje mund të gjenden në skedën Hollësitë e Çështjes. Të gjitha shpjegimet e nevojshme do t’i gjeni te [manuali i përdorimit HUDOC](#).

* Jurisprudenca e cituar mund të jetë në njërin dhe/ose në tjetrën nga dy gjuhët zyrtare (frëngjisht dhe anglisht) të Gjykatës dhe të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Me përjashtim të ndonjë shënimi të veçantë të vënë në dukje pas emrit të çështjes, referenca e cituar është ajo e një vendimi për themelin të dhënë nga një dhomë e Gjykatës. Shënimi “(vend. pran.)” shpie te një vendim i Gjykatës për pranueshmërinë, kurse shënimi “[DhM]” do të thotë se çështja është shqyrtuar nga Dhoma e Madhe.

Neni 4 i Protokollit nr. 4 – Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

“Dëbimi kolektiv i të huajve është i ndaluar.”

Fjalë kyç HUDOC

Ndalim i dëbimit kolektiv të të huajve (P4-4)

I. Zanafillat dhe objekti i nenit

1. Në kohën kur është hartuar Protokollit nr. 4, më 1963, ishte fjala për traktatin e parë ndërkombëtar që kishte të bënte me dëbimin kolektiv. Raporti i tij shpjegues tregon se neni 4 kishte si objekt që të ndalonte në mënyrë të prerë “dëbimet kolektive të llojit të atyre të ndodhura në një të kaluar të afërt”. Prandaj bihej “dakord se miratimi i [nenit 4] dhe i nenit 3, paragrafi 1 (ndalimi i dëbimit të shtetasve) nuk mund të interpretohet në asnjë mënyrë sikur është me natyrë të tillë që t’i përligjë masat për dëbim kolektiv të marra në të kaluarën” (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM], § 174).

2. Qëllimi kryesor i nenit është për të mos lejuar që shtetet të mund të largojnë ndonjë numër të huajsh pa e shqyrtuar situatën e tyre personale dhe, për pasojë, pa u dhënë atyre mundësi të parashtrajnë argumentet e tyre kundër masës së marrë nga autoriteti kompetent (*po aty*, § 177).

II. Përkufizimi i termit “dëbim kolektiv”

3. Përkufizimi i mirëpërcaktuar i termit “dëbim kolektiv” është “çdolloj mase e marrë nga autoritetet kompetente për të shtrënguar persona të huaj, si grup, që të largohen nga një vend, me përjashtim të rasteve kur një masë e tillë merret në përfundim dhe mbi bazë të një shqyrtimi të arsyeshëm e objektiv të situatës së veçantë të secilit nga të huajt që e përbëjnë grupin” (*Andric k. Suedisë* (vend. pran.); *Čonka k. Belgjikës*, § 59; *Sultani k. Francës*, § 81, dhe vendimet e Komisionit *Becker k. Danimarkës*; *K.G. k. Gjermanisë*; *O. me të tjerë k. Luksemburgut*; *Alibaks me të tjerë k. Vendeve të Ulëta*; *Tahiri k. Suedisë*). Fakti që disa të huaj janë objekt vendimesh të ngjashme nuk lejon në vetvete të dilet në përfundimin se ka një dëbim kolektiv, në qoftë se secili nga të interesuarit ka mundur individualisht t’i paraqesë para autoriteteve kompetente argumentet kundër dëbimit të tij (*Alibaks me të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, vendim i Komisionit; *Andric k. Suedisë* (vend. pran.); *Sultani k. Francës*, § 81). Por, megjithatë, kjo nuk do të thotë që aty ku ka pasur një shqyrtim të arsyeshëm e objektiv të situatës së veçantë të secilit nga të huajt, “rrethanat e vënies në zbatim të vendimeve të dëbimit nuk luajnë më asnjë rol në vlerësimin e respektimit të nenit 4 të Protokollit nr. 4” (*Čonka k. Belgjikës*, § 59).

4. Përveç kësaj, nuk ka shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 në qoftë se mungesa e një vendimi individual për dëbim është pasojë e sjelljes fajtoresh të personave të interesuar (*Berisha e Haljiti k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (vend. pran.), ku paditësit kishin paraqitur një kërkesë të përbashkët për azil dhe u ishte dhënë kështu një vendim i vetëm; *Dritsas k. Italisë* (vend. pran.), ku paditësit nuk kishin pranuar t’ia paraqitnin dokumentin e tyre të identitetit policisë, e cila ishte gjendur kështu në pamundësi për t’i hartuar vendimet e dëbimit në emrin e paditësve).

5. Mund të konsiderohet se termi “dëbim” ka të njëjtin kuptim me atë që ka në nenin 3 të Protokollit (ndalimi i dëbimit të shtetasve): sipas autorëve të Protokollit nr. 4, fjala “dëbim” duhet të interpretohet “në kuptimin e përgjithshëm që i njeh atij gjuha e përditshme (përzënie nga një vend)” (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM], § 174, me referime ndaj *punimeve përgatitore* të Protokollit

nr. 4). Në çështjen *Khlaifia me të tjerë k. Italisë* [DhM], qeveria italiane ka nënvizuar se paditësit ishin bërë objekt i një procedure të cilësuar në të drejtën e brendshme si “zmbropsje me kthim në kufi”, dhe jo si “dëbim”. Megjithatë, Gjykata nuk ka parë asnjë arsye për të mos iu përmbajtur përkufizimit të saj të përcaktuar më parë, duke vërejtur se nuk vihej në dyshim që paditësit, të cilët ndodheshin në territorin italian (fillimisht të vendosur në një qendër pritëse në ishullin e Lampeduzës, pastaj të transferuar nëpër anije të lidhura me ballamarë në portin e Palermos) i kishin larguar prej tij dhe kthyer në drejtim të Tunizisë kundër dëshirës së tyre, çka përbënte një “dëbim” në kuptimin e nenit 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 243-244).

III. Fusha individuale e zbatimit: përkufizimi i termit “të huajt”

6. “Të huajt” të cilëve u referohet neni 4 i Protokollit nr. 4 nuk janë vetëm ata të cilët janë me qëndrim të rregullt brenda territorit, por edhe “të gjithë ata që nuk kanë ndonjë të drejtë aktuale shtetësie në atë shtet, pa bërë dallim as nëse janë thjesht kalimthi ose me qëndrim a me banim, as nëse janë refugjatë apo kanë hyrë në atë vend me dëshirën e tyre, as nëse janë pa atdhe apo e kanë një shtetësi” (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM], § 174, me referime ndaj *Punimeve përgatitore* të Protokollit nr. 4; *Gjeorgjia k. Ruisë (I)* [DhM], § 168). Mënyra e formulimit të nenit 4 të Protokollit nr. 4 nuk i referohet situatës juridike të të interesuarve, ndryshe nga neni 2 i Protokollit (liria e lëvizjes së personave që ndodhen “në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti”) dhe nga neni 1 i Protokollit nr. 7 (garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve “me qëndrim të rregullt në territorin e një shteti”).

7. Në përputhje me këtë interpretim, në çështjet që i janë drejtuar asaj, Gjykata e ka zbatuar nenin 4 të Protokollit nr. 4 për persona që qëndronin në territorin e një shteti për arsye të ndryshme (azilkërkues në çështjet *Čonka k. Belgjikës* dhe *Sultani k. Francës*; migrantë në çështjen *Gjeorgjia k. Ruisë (I)* [DhM], § 170, pavarësisht nëse ata persona qëndronin në mënyrë të ligjshme ose jo në territorin e shtetit të paditur) apo ishin diktuar në det të hapur nga anije të cilat lundronin me flamur të shtetit të paditur dhe ishin kthyer në vendin nga vinin (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM]).

IV. Zbatueshmëria territoriale dhe juridiksioni

8. Shumica e çështjeve që janë çuar përpara organeve të Konventës në fushën e nenit 4 të Protokollit nr. 4 kanë pasur të bënin me të huajt të cilët ndodheshin tashmë në territorin e shtetit të paditur (*K.G. k. Gjermanisë*, vendim i Komisionit; *Andric k. Suedisë* (vend. pran.); *Čonka k. Belgjikës*). Ato nuk kanë ngritur pra ndonjë pikë në rrafshin e zbatueshmërisë territoriale.

9. Çështja *Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM] kishte të bënte me operacione diktimi në det të hapur dhe kthimi migrantësh të paligjshëm drejt Libisë nga ana e autoriteteve italiane. Gjykatës i është dashur të shqyrtojë nëse zbatohet neni 4 i Protokollit nr. 4 kur operacioni i kthimit kishte ndodhur jashtë territorit kombëtar, në këtë rast në det të hapur. Gjykata ka vërejtur se as teksti, as *punimet përgatitore* të Konventës nuk e përjashtonin zbatimin jashtëterritorial të kësaj dispozite. Përveç kësaj, po qe se neni 4 i Protokollit nr. 4 duhej të zbatohet vetëm për dëbimet kolektive të kryera nga territori kombëtar i shteteve palë në Konventë, atëherë do të kishte një pjesë të madhe të dukurive migratore bashkëkohore që do të gjendeshin jashtë fushës së veprimit të kësaj dispozite dhe ata migrantë që do të kishin zgjedhur rrugën detare, shpeshherë duke vënë jetën e tyre në rrezik, e që nuk do t’ia kishin dalë të arrinin kufijtë e një shteti, nuk do të kishin të drejtë për një shqyrtim të situatës së tyre personale para se të dëboheshin, ndryshe nga ata që do të kishin

zgjedhur rrugën tokësore. Nocioni i dëbimit, ashtu si koncepti “juridiksion”, është pa dyshim kryesisht territorial. Megjithatë, aty ku Gjykata ka gjetur se një shtet kontraktues, duke bërë përjashtim, e kishte ushtruar juridiksionin e tij jashtë territorit të vet kombëtar, ajo mund të pranonte se ushtrimi i juridiksionit jashtëterritorial të këtij shteti kishte marrë trajtën e një dëbimi kolektiv. Gjykata ka rikujtuar gjithashtu se veçantia e kontekstit detar nuk mund ta kthejë atë në një hapësirë ku nuk ka ligj. Për rrjedhojë, ajo ka dalë në konkluzionin se ato largime të huajsh që kryhen në suazë diktimesh në det të hapur nga autoritetet e një shteti në ushtrim të të drejtave të tyre të posaçme si fuqi publike, dhe që kanë si efekt pengimin e migrantëve për të mbërritur kufijtë e shtetit, madje zbrapsjen e tyre drejt një shteti tjetër, përbëjnë një ushtrim të juridiksionit të tyre, i cili e ngarkon shtetin në fjalë me përgjegjësi në fushën e nenit 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 169-182).

10. Gjykata ka ndjekur të njëjtën qasje lidhur me kapjen dhe zbrapsjen e menjëhershme nga policia kufitare të migrantëve që kishin mbërritur në mënyrë klandestine në vend, dhe e ka rrëzuar për rrjedhojë prapësimin e Qeverisë sipas të cilit neni 4 të Protokollit nr. 4 nuk zbatohet *ratione materiae* për rastet e refuzimit për të pranuar brenda territorit kombëtar persona që kishin mbërritur aty në mënyrë të paligjshme (*Sharifi me të tjerë k. Italisë e Greqisë*, §§ 210-213, që kishte të bënte me kthimin në Greqi të migrantëve që kishin hipur fshehurazi në bord anijesh për në Itali dhe të cilët kishin mbërritur në portin italian të Ankonës). Gjykata nuk e ka gjykuar si të dobishme që të përcaktonte nëse paditësit ishin kthyer pasi kishin mbërritur në territorin italian apo përpara, përderisa neni 4 i Protokollit nr. 4 zbatohet gjithsesi në të dyja situatat.

V. Shembuj dëbimesh kolektive

11. Gjykata ka dalë në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 vetëm në gjashtë çështje. Në katër prej tyre (*Čonka k. Belgjikës, Gjeorgjia k. Ruisë (I)* [DhM], *Shioshvili me të tjerë k. Ruisë, Berdenishvili me të tjerë k. Ruisë*), dëbimet vinin në shenjë individë me prejardhje të njëjtë (familje romësh të ardhur nga Sllovakia në çështjen e parë dhe shtetas gjeorgjianë në të tjerat). Në dy të tjerat (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM] dhe *Sharifi me të tjerë k. Italisë e Greqisë*), shkelja që është vënë re kishte të bënte me kthimin e një grupi të tërë personash (migrantë dhe azilkërkuar), i cili ishte kryer në mungesë të një verifikimi të përshtatshëm të identitetit të secilit nga pjesëtarët e grupit.

12. Në çështjen *Čonka k. Belgjikës*, paditësit janë kthyer me të vetmin arsyetim se koha e qëndrimit të tyre në Belgjikë i kishte kapërcyer tre muaj, kurse urdhrat për largim nga territori nuk u referoheshin fare kërkesës së tyre për azil apo vendimeve të marra rreth asaj pike. Në këto kushte, dhe duke pasur parasysh numrin e madh të personave me prejardhje të njëjtë që kishin pasur të njëjtin fat me paditësit, Gjykata çmoi se procedura e ndjekur nuk ishte me natyrë të tillë që ta përjashtonte çdolloj dyshimi rreth karakterit kolektiv të dëbimit të kritikuar. Këto dyshime përforcoheshin me një varg faktorësh: *së pari*, para kthimit të paditësve, autoritetet përgjegjëse politike kishin njoftuar organizimin e disa operacioneve të këtij lloji dhe i kishin dhënë administratës kompetente udhëzime për realizimin e tyre; *së dyti*, të gjithë të huajt në fjalë ishin thirrur njëkohësisht në komisariat; *së treti*, urdhrat që u ishin dorëzuar atyre për largim nga territori dhe për arrestim paraqitnin një formulim të njëjtë; *së katërti*, për të interesuarit kishte qenë shumë e vështirë që të merrnin kontakt me ndonjë avokat dhe *së fundi*, procedura për azil nuk kishte përfunduar ende. Me pak fjalë, nga thirrja e të interesuarve në komisariat deri në dëbimin e tyre, procedura e ndjekur nuk kishte ofruar në asnjë moment garanci të mjaftueshme që të dëshmonin për një marrje parasysh në mënyrë reale dhe të diferencuar të situatës individuale të secilit nga personat e prekur. Gjykata doli kështu në konkluzionin se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës (*po aty*, §§ 59-63).

13. Në çështjen *Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM], transferimi i paditësve (shtetas somalezë dhe eritreas) drejt Libisë ishte ekzekutuar në mungesë të çdolloj trajte shqyrtimi të situatës individuale të secilit paditës. Paditësit nuk ishin bërë objekt për asnjë procedurë identifikimi nga ana e autoriteteve italiane, të cilat ishin mjaftuar duke i hipur paditësit nëpër anije dhe duke i zbritur ata në brigjet libiane. Përveç kësaj, personeli në bord të anijeve ushtarake nuk ishte i trajnuar për të kryer bashkëbisedime individuale dhe nuk ishte i ndihmuar me përkthyes e me këshilltarë juridikë. Gjykata doli kështu në konkluzionin se largimi i paditësve kishte qenë me karakter kolektiv, në kundërshtim me nenin 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 185-186).

14. Çështja *Gjeorgjia k. Ruisë (I)* [DhM] kishte të bënte me urdhrin e dhënë nga gjykatat ruse për të dëbuar mijëra shtetas gjeorgjianë. Gjykata vuri re se, ndonëse për secilin shtetas gjeorgjian kishte pasur një vendim gjyqësor, mënyra e zhvillimit të procedurave për dëbim gjatë asaj periudhe (nga shtatori 2006 deri në janar 2007) si edhe numri i shtetasve gjeorgjianë të dëbuar e bënë të pamundur një shqyrtim të arsyeshëm dhe objektiv të situatës individuale të secilit prej tyre. Përveç kësaj, Federata Ruse kishte zbatuar një politikë të bashkërenduar arrestimi, burgimi dhe dëbimi shtetasish gjeorgjianë. Ndonëse Gjykata nuk e vuri në pikëpyetje të drejtën që kanë shtetet për t'i përcaktuar në mënyrë sovrane politikat e tyre të imigrimit, ajo çmoi se vështirësitë në administrimin e valëve migratore nuk mund ta përligjin përdorimin e disa praktikave të papajtueshme me Konventën. Gjykata doli në konkluzionin se dëbimet e shtetasve gjeorgjianë nuk ishin ekzekutuar mbi bazën e një shqyrtimi të arsyeshëm e objektiv të situatës së veçantë të secilit prej tyre dhe se ato kishin përbërë një praktikë administrative në kundërshtim me nenin 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 171-178).

15. Çështja *Shioshvili me të tjerë k. Ruisë* kishte të bënte me vendimin për të dëbuar nga territori rus një grua gjeorgjiane shtatzënia e së cilës ishte e avancuar dhe e cila ishte e shoqëruar me katër fëmijët e saj të vegjël. Gjykata doli në konkluzionin se kishte pasur shkelje të kësaj dispozite ndaj nënës, ngaqë kjo i ishte nënshtruar në vjeshtën e vitit 2006 një praktike administrative që i dëbonte shtetasit gjeorgjianë pa e shqyrtuar siç duhej rastin e tyre individual (§ 71). Gjykata doli në të njëjtin konkluzion në çështjen *Berdzenishvili me të tjerë k. Ruisë*, §§ 83-84, lidhur me katërmbëdhjetë shtetas gjeorgjianë dëbimi i të cilëve ishte urdhëruar nga gjykatat kombëtare gjatë së njëjtës periudhë.

16. Në çështjen *Sharifi me të tjerë k. Italisë e Greqisë*, Italia kishte kthyer disa individë (shtetas afganë) drejt Greqisë duke argumentuar se vetëm Greqia ishte kompetente në suazën e sistemit të Dublinit (i cili shërben për të përcaktuar se cili shtet anëtar i Bashkimit Evropian duhet ta shqyrtojë kërkesën për azil të paraqitur në një prej shteteve anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë) për të marrë vendim rreth kërkesave eventuale për azil. Gjykata çmoi megjithatë se autoritetet italiane duhej të kishin bërë një analizë të individualizuar të situatës për secilin paditës, me qëllim që të përcaktonin nëse Greqia ishte efektivisht kompetente rreth kësaj pike, në vend që t'i dëbonin ata në bllok. Asnjë trajtë largimi kolektiv e pa dallim nuk mund të përligjej duke iu referuar sistemit të Dublinit, zbatimi i të cilit duhej, në të gjitha rastet, të bëhej në një mënyrë të pajtueshme me Konventën. Përveç kësaj, Gjykata mbajti shënim disa raporte që përputheshin mes tyre, të cilët ishin paraqitur nga palë të treta ose ishin marrë pranë burimesh të tjera ndërkombëtare, dhe që tregonin episode kthimi pa dallim drejt Greqisë nga ana e autoriteteve kufitare italiane në portet e detit Adriatik, duke u hequr të interesuarve çdo të drejtë materiale dhe procedurale. Sipas këtyre burimeve, ishte vetëm në dorë të dëshirës së mirë të policisë kufitare që personat e kapur pa dokumente të mund të viheshin në kontakt me ndonjë përkthyes e me nëpunës në gjendje për t'u dhënë atyre informacionet minimale lidhur me të drejtën e azilit dhe me procedurën përkatëse. Në të shumtën e rasteve, këta persona u dorëzoheshin menjëherë kapitenëve të trageteve për t'i kthyer përsëri në Greqi. Në dritën e të gjitha këtyre elementeve, Gjykata doli në konkluzionin se kthimet e menjëhershme të cilave u ishin nënshtruar paditësit përbënin dëbime kolektive dhe pa dallim, në kundërshtim me nenin 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 214-225).

VI. Shembuj masash që nuk përbëjnë dëbim kolektiv

17. Në çështjen *Sultani k. Francës*, Gjykata ka vënë re se situata e paditësit kishte qenë objekt i një shqyrtimi individual. Paditësi e kishte pasur mundësinë për t'i paraqitur argumentet kundër dëbimit të tij dhe autoritetet kombëtare kishin marrë parasysh jo vetëm kontekstin e përgjithshëm që mbisundonte në Afganistan, por edhe deklaratat e paditësit lidhur me situatën e tij personale dhe me rreziqet e pretenduara në rast kthimi në vendin e tij të prejardhjes (*po aty*, § 83, çështje ku dëbimi i paditësit drejt Afganistanit me anë të një "fluturimi kolektiv" nuk ishte ekzekutuar për arsye të masës së ndërmjetme të rekomanduar nga Gjykata mbi bazën e nenit 39 të Rregullores së saj; *Ghulami k. Francës* (vend. pran.), ku është ndjekur e njëjta qasje lidhur me një dëbim drejt Afganistanit, i cili është vënë në ekzekutim; shih gjithashtu çështjet *Andric k. Suedisë* (vend. pran.) dhe *Tahiri k. Suedisë*, vendim i Komisionit, në të cilat nuk është vënë re asgjë që të dukej në pamje të jashtme si dëbim kolektiv).

18. Në qoftë se situata personale e të interesuarve është bërë objekt i një shqyrtimi individual, Gjykata nuk do të dalë në konkluzion se ka pasur shkelje, edhe sikur të interesuarit të jenë çuar së bashku në komisarjat policie, disa prej tyre të jenë dëbuar në grupe e vendimet për dëbim si edhe letrat që i shoqërojnë ato të jenë hartuar me formula shabllon, pra me terma identikë, dhe të mos u referohen në mënyrë specifike vendimeve të mëparshme lidhur me procedurën e azilit (*M.A. k. Qipros*, §§ 252-255, lidhur me një individ i cili pretendonte se kishte qenë objekt i një operacioni dëbimi kolektiv në të njëjtën kohë me një grup kurdësh nga Siria; krahaso me rrethanat e përshkruara në çështjen *Čonka k. Belgjikës*, § 10). Thjesht fakti që ishte bërë një gabim lidhur me situatën e disave nga të interesuarit (në veçanti lidhur me paditësin, meqenëse vendimi për ta dëbuar atë ishte lëshuar ndërkohë që procedura për azil që ai kishte nisur ishte ende e papërfunduar) nuk mund të interpretohet si një shenjë që tregon një dëbim kolektiv (*M.A. k. Qipros*, §§ 134 e 254).

19. Në çështjen *Khlaifia me të tjerë k. Italisë* [DhM], Gjykata ka saktësuar se neni 4 i Protokollit nr. 4 nuk garanton në çdo rrethanë të drejtën për një bashkëbisedim individual; kërkesat e kësaj dispozite mund të përmbushen atëherë kur çdo i huaj e ka mundësinë, reale dhe efektive, për t'i paraqitur argumentet që e kundërshtojnë dëbimin e tij, dhe kur këto të fundit shqyrtohen në një mënyrë të përshtatshme nga autoritetet e shtetit të paditur (*po aty*, § 248). Paditësit ishin identifikuar dy herë, shtetësia e tyre ishte përcaktuar dhe ata kishin pasur një mundësi reale dhe efektive për t'i paraqitur argumentet që e kundërshtonin dëbimin e tyre. Edhe pse dekretet për zbrapsje ishin hartuar me terma të krahasueshëm (të vetmet dallime kishin të bënin me të dhënat personale të migrantëve në fjalë) e pse një numër i madh migrantësh tunizianë ishin dëbuar në kohën e ngjarjeve të vëna nën akuzë, Gjykata ka çmuar se natyra relativisht e thjeshtë dhe e standardizuar e dekretëve për zbrapsje mund të shpjegohej me faktin se paditësit nuk zotëronin asnjë dokument të vlefshëm udhëtimi dhe nuk kishin paraqitur si argument as drujtje për keqtrajtme në rast kthimi, as pengesa të tjera ligjore për dëbimin e tyre. Natyra relativisht e thjeshtë dhe e standardizuar e dekretëve nuk ishte pra e paarsyeshme në vetvete. Për këtë arsye, në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, kthimet pothuajse të njëkohshëm të tre paditësve nuk jepnin mundësi të dilej në konkluzionin që dëbimi i tyre të kishte qenë "kolektiv" (*po aty*, §§ 249-254).

20. Në çështjet *Shioshvili me të tjerë k. Rusisë*, §§ 70-72, dhe *Berdzenishvili me të tjerë k. Rusisë*, §§ 81-82, në mungesë të një urdhri për dëbim të dhënë ndaj paditësve nga ndonjë gjykatë apo çdo autoritet tjetër, Gjykata nuk ka qenë në gjendje të dalë në përfundimin se ata kishin qenë objekt i një "mase për të shtrënguar persona të huaj, si grup, që të largohen nga një vend". Kjo qasje vlen edhe sikur të ekzistonte një praktikë administrative që ta shpjegonte frikën e paditësve në të dyja çështjet se mos arrestoheshin, burgoseshin dhe dëboheshin, e sikur të ishte pra e kuptueshme që ata të largoheshin nga vendi përpara një urdhri zyrtar. Por, për mendimin e Gjykatës, një situatë e tillë nuk mund të barazohej me një urdhër dëbimi apo me çdo masë tjetër zyrtare shtrënguese. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4.

VII. Marrëdhënia me nenin 13 të Konventës

Neni 13 i Konventës – E drejta për zgjidhje efektive

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në (...) Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Fjalë kyç HUDOC

Zgjidhje efektive (N. 13) – Ankesë e pranueshme (N. 13) – Organ kombëtar (N. 13)

21. Nocioni i zgjidhjes efektive në kuptimin e nenit 13 të Konventës nënkupton që zgjidhja të jetë me natyrë të tillë që të mos e lejojë ekzekutimin e disa masave që janë në kundërshtim me Konventën dhe pasojat e të cilave janë potencialisht të pakthyeshme. Për rrjedhojë, neni 13 e kundërshton që masa të tilla të ekzekutohen që pa përfunduar shqyrtimi prej autoriteteve kombëtare i pajtueshmërisë së tyre me Konventën (*Çonka k. Belgjikës*, § 79). Nga kjo del se zgjidhja duhet të ketë një karakter pezullues për t'i përmbushur kërkesat e nenit 13 të Konventës të bashkuar me nenin 4 të Protokollit nr. 4 (*po aty*, §§ 77-85, lidhur me efektivitetin e zgjidhjeve pranë Këshillit të Shtetit). Megjithatë, është e udhës të shënohet se mungesa e efektit pezullues të një zgjidhjeje kundër një vendimi për largim nuk përbën në vetvete një shkelje të nenit 13 të Konventës të bashkuar me nenin 4 të Protokollit nr. 4 në qoftë se një paditës nuk paraqet si argument një rrezik real për shkelje të të drejtave të tij në bazë të neneve 2 dhe 3 në vendin e mbërritjes (*Khlaifia me të tjerë k. Italisë* [DhM], § 281). Në një rast të tillë, Konventa nuk u dikton shteteve detyrimin absolut që të garantojnë një zgjidhje me të drejtë të plotë pezulluese, por kufizohet me kërkesën që personi në fjalë të ketë një mundësi efektive për ta kundërshtuar vendimin për dëbim duke përfituar një shqyrtim mjaft të thelluar të ankesave të tij nga një organ i brendshëm i pavarur dhe i paanshëm (*po aty*, § 279).

22. Mungesa e çdo procedure të brendshme që t'u japë mundësi azilkërkuesve potencialë për t'i parashtruar një autoriteti kompetent ankesat e tyre të bëra mbi bazën e Konventës (në këndvështrimin e nenit 3 të Konventës – ndalimi i torturës dhe i trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese – dhe të nenit 4 të Protokollit nr. 4) si edhe për të përfituar një kontroll të vëmendshëm e të rreptë të kërkesave të tyre para se të vihet në ekzekutim masa për largim, mund të çojë gjithashtu në një shkelje të nenit 13 të Konventës (*Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë* [DhM], §§ 201-207; *Sharifi me të tjerë k. Italisë e Greqisë*, §§ 240-243). Në disa rrethana, ekziston një lidhje e qartë midis vënies në ekzekutim të dëbimeve kolektive dhe faktit se të interesuarit janë penguar konkretisht për të kërkuar azilin ose për të pasur qasje në çfarëdo procedure tjetër kombëtare që i përmbush kërkesat e nenit 13 (*po aty*, § 242).

23. Megjithatë, përderisa mungesa e zgjidhjeve efektive dhe me mundësi qasjeje shqyrtohet edhe në këndvështrimin e nenit 4 të Protokollit nr. 4 të marrë më vete, Gjykata mund të çmojë gjithashtu në një çështje të caktuar se nuk është me vend që ky aspekt të shqyrtohet më vete në këndvështrimin e nenit 13 të Konventës (*Gjeorgjia k. Rusisë (I)* [DhM], § 212).

Lista e çështjeve të cituara

Jurisprudenca e cituar në këtë udhëzues u referohet disa vendimeve të dhëna nga Gjykata, si edhe disa vendimeve e raporteve të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut (“Komisioni”).

Përveçse kur ka ndonjë shënim të veçantë të vënë pas emrit të çështjes, referenca e cituar është ajo e një vendimi për themelin të dhënë nga një dhomë e Gjykatës. Shënimi “(vend. pran.)” i referohet një vendimi për pranueshmërinë të Gjykatës, kurse shënimi “[DhM]” do të thotë se çështja është gjykuar nga Dhoma e Madhe.

Hiperlidhjet e çështjeve të cituara në versionin elektronik të këtij udhëzuesi shpjen drejt bazës së të dhënave HUDOC (<<http://hudoc.echr.coe.int>>), e cila lejon qasje në jurisprudencën e Gjykatës (vendime Dhome të Madhe, Dhome e Komiteti, çështje të njoftuara, mendime këshillimore dhe përmbledhje juridike të nxjerra nga Shënimi informativ rreth jurisprudencës), si edhe në atë të Komisionit (vendime dhe raporte) e në rezolutat e Komitetit të Ministrave.

Gjykata i jep vendimet e saj në anglisht dhe/ose në frëngjisht, dy gjuhët e saj zyrtare. Baza e të dhënave HUDOC jep gjithashtu qasje te përkthime të disa prej çështjeve kryesore të Gjykatës në mbi tridhjetë gjuhë jozyrtare. Përveç kësaj, ajo përmban lidhje drejt rreth njëqind përmbledhjesh jurisprudence në linjë të prodhuara nga të tretë.

—A—

Alibaks me të tjerë k. Vendeve të Ulëta, nr. 14209/88, vendim i Komisionit i 16 dhjetorit 1988,
Vendime dhe raporte 59
Andric k. Suedisë (vend. pran.), nr. 45917/99, 23 shkurt 1999

—B—

Becker k. Danimarkës, nr. 7011/75, vendim i Komisionit i 3 tetorit 1975, Vendime dhe raporte 4
Berdzenishvili me të tjerë k. Rusisë, nr. 14594/07 e 6 të tjerë, 20 dhjetor 2016
Berisha e Haljiti k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (vend. pran.), nr. 18670/03, GjEDNj 2005-VIII (pjesë të zgjedhura)

—C—

Čonka k. Belgjikës, nr. 51564/99, GjEDNj 2002-I

—D—

Dritsas k. Italisë (vend. pran.), nr. 2344/02, 1 shkurt 2011

—G—

Ghulami k. Francës (vend. pran.), nr. 45302/05, 7 prill 2009

—GJ—

Gjeorgjia k. Ruisë (I) [DhM], nr. 13255/07, GjEDNj 2014 (pjesë të zgjedhura)

—H—

Hirsi Jamaa me të tjerë k. Italisë [DhM], nr. 27765/09, GjEDNj 2012

—K—

K.G. k. Gjermanisë, nr. 7704/76, vendim i Komisionit i 1 marsit 1977
Khlaifia me të tjerë k. Italisë [DhM], nr. 16483/12, GjEDNj 2016 (pjesë të zgjedhura)

—M—

M.A. k. Qipros, nr. 41872/10, GjEDNj 2013 (pjesë të zgjedhura)

—O—

O. me të tjerë k. Luksemburgut, nr. 7757/77, vendim i Komisionit i 3 marsit 1978

—S—

Sharifi me të tjerë k. Italisë e Greqisë, nr. 16643/09, 21 tetor 2014
Shioshvili me të tjerë k. Ruisë, nr. 19356/07, 20 dhjetor 2016
Sultani k. Francës, nr. 45223/05, GjEDNj 2007-IV (pjesë të zgjedhura)

—T—

Tahiri k. Suedisë, nr. 25129/94, vendim i Komisionit i 11 janarit 1995